- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të kësaj Shtojce.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 *Ne përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit financiare, në një vlerë të pakten prej 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë).*

Operatorët ekonomikë që kanë aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet të kenë xhiro mesatare, në vlerën e kerkuar të pakten prej 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë).

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhironja vjetore për vitet e siperpërmendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

2.3 Për kapacitetin teknik:

- 2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 1,900,000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë.*

Lidhur me këtë pikë: Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin

privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit / distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

2.3.3 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme ose ekuivalent (të përkthyer dhe të noterizuara) dhe të vlefshme si vijon:*

- **ISO 9001:** ose ekuivalente në fushën e cilësisë në të njëjtën fushë me objektin e prokurimit, (të vlefshme).
- **ISO 27001:** ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të sigurisë së informacionit, (të vlefshme).
- **ISO 22301:** ose ekuivalente për kërkesat e planifikimit, krijimit, zbatimit, operimit, monitorimit, rishikimit, mirëmbajtjen, përmirësimin në fushën e ofrimit të shërbimeve të sigurisë së informacionit, (të vlefshme).
- **ISO 50001:** ose ekuivalente përmbështet organizatat në të gjithë sektorët të përdorin energjinë në mënyrë më efikase, përmes zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të energjisë, (të vlefshme).

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues për të patur njohjen e produkteve që do ofrojnë për realizimin e kontratës duhet të provojë se ka në stafin e tij kapacitetet teknike dhe profesionale si më poshtë vijon:*

- *Për të garantuar siguri, autenticitetin dhe disponueshmërinë e komunikimit në platformat ekzistuese Microsoft, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të kualifikuar për **Microsoft Security** ose ekuivalente. Punonjësi duhet të ketë jo më pak se 5 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion.*
- *Për të garantuar menaxhimin e sistemeve kompjuterike Microsoft operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të kualifikuar **Microsoft Certified Professional** ose ekuivalente. Punonjësi duhet të ketë jo më pak se 5 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion.*
- *Për të garantuar siguri e komunikimit në rrjetet lokale të komunikimit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të kualifikuar për **Network Security** ose ekuivalente. Punonjësi duhet të ketë jo më pak se 5 vite eksperience pune në IT, diplomë në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike/Telekomunikacion.*
- *Për të garantuar menaxhimin e rrjetave kompjuterike të transmetimit të të dhënave,*

operatori ekonomik duhet të ketë te pakten një punonjës të kualifikuar në CCNA ose ekuivalente. Punonjesi duhet të ketë diplomë në Shkenca Elektronike/ Kompjuterike/ Informatike/Telekomunikacion.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues për të gjithë stafin e kërkuar me sipër operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- i) listepagesat ku të konfirmohet që janë punonjës të operatorit ekonomik të pakten për 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- ii) CV-të, diplomat dhe certifikatat që vërtetojnë se punonjësi i disponon aftësitë profesionale të tij në përputhje me kërkesat e lartpërmendura.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për të gjithë mallrat objekt prokurimi, pjesë që i përkasin të dhënave teknike, të jete e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.*

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të ciletose se mallrat e ofruara prej Tij, janë të reja dhe jo të rikonstruktura.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Blerja e licensave për software-in e menaxhimit të logjikës së PLC në RTU e implementuara në HEC-e dhe analizatorit të protokolleve.

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia	Cmimi Njesi	Cmimi total	Afati
1	Softuare për menaxhimin e logjikës së PLC në RTU					
1.1	Licensa për software-in	Copë	1			
2	Softuare për analizimin e protokollit ICCP					
2.1	License për IEC 60870-6 (TASE.2/ICCP) (Client)	Copë	1			
2.2	License për IEC 60870-6 (TASE.2/ICCP) (Server)	Copë	1			
3	Softuare për menaxhimin e pajisjeve SIEMENS PLC S7-300, SIMATIC IPC227E, S7-mEC					
3.1	Licensa për software-in	Copë	1			

Përmbajtja

1.	<u>Rreth ketij dokumenti</u>	4
2.	<u>Softuare për menaxhimin dhe programimin e logjikës së PLC në RTU-të e implementuara në HEC-e</u>	5
3.	<u>Funksionet e Softuarit për menaxhimin dhe programimin e logjikës së PLC</u>	6
3.1.	<u>Operimi i logjikes se PLC :</u>	6
4.	<u>Software për analizimin e protokolleve të përdorura për komunikim ndërmjet sistemit SCADA të OST Sh.a dhe sistemeve SCADA të TSO-ve fqinje</u>	7
5.	<u>Kërkesat mbi funksionet e Softuarit</u>	7
6.	<u>Software për konfigurimin, programimin, testimin dhe diagnostifikimin e pajisjeve PLC</u>	

SIEMENS S7-300, SIMATIC IPC227E, S7-mEC.....	8
7. Kërkesat për testimet.....	9
8. Kërkesat për dokumentacionin.....	9

Rreth ketij dokumenti

Aktualisht OST sh.a. ka të implementuar sisteme të ndryshme që realizojnë shkëmbimin e të dhënave nëpërmjet protokolleve të komunikimit si më poshtë:

- Protokolli i komunikimit IEC 60870 – 5 -104
- Protokolli IEC 61131-3
- Protokolli i komunikimit IEC 60870-6 (TASE.2/ICCP)

Nëpërmjet protokolleve të komunikimit realizohet, transmetim në kohë reale të të dhënave të ndryshme drejt të gjithë sistemit energjitik ku përfshihen nënstacionet e tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV si dhe të gjithë hidrocentralet që janë të lidhur me sistemin e transmetimit energjitik, gjithashtu realizohen komunikime me të gjithë vendet anetare të ENTSO-E duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale me Qendrat Dispecerike. Të dhënat që transmetohen janë të dhëna të një rëndësie të vecante që kanë të bëjnë me kontrollin, monitorimin dhe operimin.

Për të shmangur shkëmbimin e informacioneve të panevojshme si dhe të dhënave që mund të krijojnë probleme në sistemin SCADA është e nevojshme që para se të realizohet një lidhje e re me sistemin SCADA të testohet nëpërmjet analizatorit të protokolleve. Për arsye të funksionimit normal të paisjeve PLC dhe mirëmbajtjes së tyre duhet të zotërohen licensa për softuerin që bën të mundur menaxhimin e logjikës së PLC-ve .

Softuare për menaxhimin dhe programimin e logjikës së PLC në RTU-të e implementuara në HEC-e

Duhet të ofrohet një mjet i fuqishëm softuerik për përgatitjen e logjikave të programueshme specifike për përdoruesin.

Kjo do të thotë që programi (mjeti) inxhinierik i RTU-së duhet të jetë në gjendje të kryejë detyrën për një RTU të vetme, të pavarur, si dhe të jetë në gjendje të integrohet në një koncept të përgjithshëm të inxhinierimit së të dhënave për një sistem kontrolli në rrjet.

Për të pasur një fleksibilitet më të lartë për zgjerimet, konfigurimet dhe modifikimet, programi

inxhinjerik duhet të lejojë shkarkimin e skedarëve në RTU në stacionet përkatëse përmes INTRANET-it duke përdorur teknologjinë WEB ose përmes linjës direkte së komunikimit, në rastet kur protokoli mbështet transferimin e skedarëve.

Softi i programimit PLC duhet të lejojë programimin sipas standardit të programimit IEC 61131-3. Metodatat e mëposhtme të programimit do të jenë në varësi të preferencës së përdoruesit:

- Diagrami i funksionit bllok (FBD)
- Lista e udhëzimeve (IL)
- Teksti i strukturuar (ST)
- Diagrami shkallë (LD)
- Grafiku i funksionit sekuencial (SFC)

Softueri duhet të operohet në formë intuitive dhe duhet ta mbështesë përdoruesin në të gjitha fazat e projektit të automatizmit si :

- Trajtimi i projektit
- Krijimi i programit të PLC
- Parametrizimi dhe konfigurimi i PLC
- Gjenerimi i kodit
- Testimi, komisionimi dhe mirëmbajtja
- Dokumentim dhe arkivim

Funksionet e Softuarit për menaxhimin dhe programimin e logjikës së PLC

- Menaxheri i projektit duhet të përfshijë menaxhimin e bibliotekës
- Redaktor plotësisht grafik
- Simulim i integruar i PLC me përgjigje kohore
- Krahasimi i programit për të gjithë redaktorët e IEC dhe të dhënat e konfigurimit
- Konvertimi i kodit në burim (FBD / LD / IL)
- Funksionet e korigjimit dhe funksionimit të tilla si ndryshimet në linjë (online), analizues logjik, dritaret e veçantë analize, tregues i pikave të ndarjes, modë pune e vetëm një hapi, mbishkrimi/detyrimi (overwriting/forcing) i ndryshoreve dhe recetave
- Zgjedhja e gjuhës për dokumentacionin e projektit të krijuar nga përdoruesi
- Sistemi i detajuar, i ndihmës direct nga konteksti.
- Mundëson import/eksport me sisteme të jashtme programimi dhe simulimi (PLCopen)

- Importi i kodit Matlab Simulink XML
- Qasje simbolike të variablave PLC. Brenda një konfigurimi RTU, variablave simbolike PLC mund të hartohen me emër që i përshkruan pikave të të dhënave. Funksionaliteti i futjes të të dhënave simbolike të variablave të PLC mundëson përdoruesin të zhvillojë kodin e funksionit që mund të ekzekutohet në disa RTU pa pasur nevojë për përpilim të ri.

Operimi i logjikës së PLC :

- RTU do të mbështesë menaxhimin e parametrave PLC jashtë programit të PLC. Moduli për menaxhimin e parametrave të PLC duhet të mundësojë modifikimin e parametrit PLC gjatë kohës së ekzekutimit përmes një faqe në Web të RTU pa ndryshuar kodin PLC.
- Mundësia për të ruajtur statusin e variablave si ruajtje e ndryshueshme. Një sasi e të dhënave të programit PLC mund të ruhet në kartën SD të RTU. Këto të dhëna do të rivendosen në program pas mbarimit të procedurës të rinisjes të sistemit. Ruajtja manuale dhe ciklike duhet të jetë e mundur.
- Duhet të suportohet Kanali i të Dhënave Transparente. Përmbajtja e cila transferohet duke përdorur TDC është kuptohet si anashkalim i rrjedhës të rregullt të kalimit të sinjalit të RTU. Komunikimi transparent i kanalit të të dhënave bazohet në një model komunikimi kërkesë/përgjigje.

Software për analizimin e protokolleve të përdorura për komunikim ndërmjet sistemit SCADA të OST Sh.a dhe sistemeve SCADA të TSO-ve fqinje.

TASE.2/ICCP (Inter-Control Center Communications Protocol) është një protokoll i cili ka standartizuar komunikimin ndërmjet qendrave të kontrollit. ICCP përdor një standart shumë të sigurt ekzistues si MMS (Manufacturing Message Specification).

Ky protokoll mundëson shkëmbimin e të dhënave si :

- Matje dhe indikacione në kohë reale
- Të dhëna historike të tipit “vlera mesatare orare” etj.
- Raporte të parapërcaktuara
- Të dhëna skedulimi

Software-i për analizimin e protokolleve të komunikimit duhet të bëjë të mundur shfaqjen e mesazheve të deshifruara hyrëse dhe dalëse për protokollin e mëposhtme të përdorura nga sistemet e OST Sh.a për komunikim ndërmjet pajisjeve :

- IEC 60870-6 (TASE.2/ICCP) Client/Server.

Kërkesat mbi funksionet e Softuarit

Software-i duhet të shfaqë dhe të analizoj cdo mesazh duke përmbushur kërkesa si :

- Filtrimin e informacionit të shfaqur sipas dëshirës së përdoruesit
- Shfaqja e kanaleve, sesioneve dhe sektorëve të përzgjedhur
- Të lejojë kopjimin e informacioneve të shfaqura në “Windows Clipboard” dhe ekzaminimin e mesazheve të mëparshme.
- Të lejojë opsionin e kërkimit duke e lehtësuar gjetjen e mesazheve specifike nga përdoruesi
- Log-et e gjeneruara nga ky software mbi analizimin e protokolleve duhet të ruhen si file-e “Text” në mënyre që të mund të analizohen në një moment të dytë.
- Log-et duhet të mund të zgjidhen në mënyre selektive dhe të kenë të bashkangjitur kohën përkatëse.

Software-i duhet të punojë ne sistemet e operative të mëposhtme :

- Windows 10 IoT
- Windows Embedded Standard 7
- Windows 7 (32-bit and 64-bit)
- Windows Server 2008 (64-bit)
- Windows 8 (32-bit and 64-bit)
- Windows Server 2012 (64-bit)
- Windows 10 (32-bit and 64-bit)
- Windows Server 2016 (64-bit)

Parametrat minimal të PC-ve në të cilat ky software duhet të operojë duhet të jenë :

- Procesor 2.4 GHz multi-core
- 4GB RAM
- Windows 7 ose version më i ri
- Microsoft .NET 4.0 Framework

Licensa për këtë software duhet të aktivizohet dhe ruhet në celes hardware-ik “Dongle” për të bërë të mundur përdorimin e software-it në ambiente të ndryshme sipas nevojës së momentit. Përdorimi i celave hardware është fleksibel për sisteme të shërndara dhe një license mund të

shfrytëzohet nga me shume sisteme.

Software duhet të vijë në versionin e fundit të tij në momentin e shfaqjes së ofertës

Software për konfigurimin, programimin, testimin dhe diagnostifikimin e pajisjeve PLC SIEMENS S7-300, SIMATIC IPC227E, S7-mEC.

Kërkohet një licensë për një program kompjuterik i cili lejon përdoruesin për konfigurimin, programimin, testimin dhe diagnostifikimin e pajisjeve PLC SIEMENS S7-300, SIMATIC IPC227E, S7-mEC.

Seria e pajisjeve SIMATIC S7 është një pajisje e cila përdoret gjërësisht në industri si sistem automatizimi për kontrollin dhe monitorimin e nënstacioneve, njësive të prodhimit, etj.

Programi duhet të mundësojë programim të nivelit të lartë në përputhje me standartin IEC 61131, me anë të gjuhëve të programimit :

- LD (Ladder Diagram) – Diagram shkallë
- FBD (Function Block Diagram) – Diagram I funksionit bllok
- SCL (Structured Text) – Tekst I strukturuar

Software-i duhet të mundësojë një librari me programet më të përdorura të cilat duhet të jenë gati për përdorim.

Software-i duhet të punojë ne sistemet e operative të mëposhtme :

- Windows 10 IoT
- Windows Embedded Standard 7
- Windows 7 (32-bit and 64-bit)
- Windows Server 2008 (64-bit)
- Windows 8 (32-bit and 64-bit)
- Windows Server 2012 (64-bit)
- Windows 10 (32-bit and 64-bit)
- Windows Server 2016 (64-bit)

Licensa për këtë software duhet të vijë në formë “Dongle” për të bërë të mundur përdorimin e software-it në ambiente të ndryshme sipas nevojës së momentit.

Kërkesat për testimet

Nivelet e përcaktuara të testimit duhet të verifikojnë konfigurimin, komunikimin, monitorimin e të dhënave që do të shkëmbehen në kohe reale. Pajtueshmëria me kërkesat verifikohet me anë të simulimeve dhe testeve, gjithashtu duhet të verifikohen edhe kërkesat e performancës së këtij specifikimi.

Testet janë renditur si më poshtë:

- Testimi i të dhënave duke përdorur softueret dhe licensat përkatëse
- Testimi i gjuheve të programimit specifike të secilit nga softet

Kërkesat për dokumentacionin

Qëllimi i kësaj pike është sigurimi i dokumentacionit të duhur nga kontraktuesi. Dokumentet do të dorëzohen në gjuhën angleze dhe ato që mund të përcaktohet më vonë nga Blerësi. Për dorëzimin e dokumentacioneve mund të përdoren USB, CD dhe DVD.

Ne respektim të nenit 23 të LPP –se ne të gjitha rastet kur ne specifikimet teknike permendet “marke” përfshihet termi “ekuivalente”.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Te dhena te plotesuar nga AK				Te dhenat qe duhen plotësuar nga Ofertuesi		
1	2	3	4	5	6	7
Nr.	Përshkrimi i paisjeve të kërkuara	Njësia	Sasia	Emri i kompanise prodhuese	Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit	Nr. i faqes se ketij katalogu si dhe Nr references ose Kodi i artikullit nxjerre nga manuali i prodhuesit
1	Software per menaxhimin e logjikes se PLC ne RTU					
1.1	Licenca per software	cope	1			
2	Software per analizimin e protokollit ICCP					
2.1	Licence per IEC 60870-6 (TASE.2/ICCP) (Client)	cope	1			
2.2	Licence per IEC 60870-6 (TASE.2/ICCP) (Server)	cope	1			
3	Software per menaxhimin e pajisjeve SIEMENS PLC S7-300, SIMATIC IPC227E, S7-mEC					
3.1	Licenca per software	copë	1			
Nr.						
	Përshkrimi i paisjeve të kërkuara	Njësia	Sasia			

Afatet e lëvrimit:

1 (një) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës.

Ne respektim te nenit 23 te LPP –se ne te gjitha rastet kur ne specifikimet teknike permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalente”.

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [____]/është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim

- të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha

dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikatat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë

të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.
